

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Flying Tiger Copenhagen, flet Silvio Qyqja, Drejtor i Pergjithshem per rajonin e Ballkanit Perendimor                                                                                                                                                                                     |
| ADRESA  | <a href="https://kohajone.com/aktualitet/flying-tiger-copenhagen-flet-silvio-qyqja-drejtor-i-perg-jithshem-per-rajonin-e-ballkanit-perendimor/">https://kohajone.com/aktualitet/flying-tiger-copenhagen-flet-silvio-qyqja-drejtor-i-perg-jithshem-per-rajonin-e-ballkanit-perendimor/</a> |
| BURIMI  | kohajone.com                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                    |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 23 shtator 2026, 05:17:18 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 13:03:30 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | f57762deb529781e9d6fb2a4c0038c7a33f7a7c27c90fcd1f4b0362ceb09cde4 |
| TEKSTI     | d980fa6e09888462ac629619483eb8276e1bc30239ba8619db0cbff7c44d8fc5 |
| PAMJA      | 8a3eb804ecadf06fb9c4ad4d2c8b077752efdeddf2a5f226cb7bcb1149c6fe26 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 0c68f229b0a943dc8326b37bf924665322cd7840027de72b784941dfd325f7eb                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0c68f229b0a943dc8326b37bf924665322cd7840027de72b784941dfd325f7eb>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Flying Tiger Copenhagen, flet Silvio Qyqja, Drejtor i Pergjithshem per rajonin e Ballkanit Perendimor

AKTUALITET EKONOMI E MARTË, 22 SHTATOR 2026 15:03



Interviste me z. Silvio Qyqja, Drejtor i Pergjithshem per rajonin e Ballkanit Perendimor.

1. Flying Tiger Copenhagen hyri në tregun shqiptar në tetor 2025, si pjesë e strategjisë së zgjerimit të kompanisë. Cilët ishin faktorët kryesorë që e bënë Shqipërinë dhe rajonin tërheqës për investim dhe si e vlerësoni ecurinë e aktivitetit deri më tani?

Shqipëria dhe tregjet e rajonit përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm zhvillimi, të mbështetur nga një konsumator relativisht i ri, i hapur ndaj markave ndërkombëtare dhe gjithnjë e më i orientuar drejt produkteve që kombinojnë cilësinë, dizajnin dhe çmimin e arsyeshëm.

## LAJMET KRYESORE



Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit



Kryeministri Rama shkarkon nga Amerika kreun e SHISH, Vlora Hyseni



Trump falënderon Kosovën dhe Shqipërinë në OKB: Kam një vendim të madh lidhur me Iranin



Euro nën 92 lekë: A po e forcon krimi monedhën shqiptare?



Sesioni i 81 i Asamblesë së Përgjithshme të OKB/ Trump darkë me liderët, i pranishëm edhe Rama

## TË PËRZGJEDHURA



1. Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



2. Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...



3. Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"



4. Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar..."



5. Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?

## MË TË LEXUARAT

Në këtë kontekst, besuam se koncepti i Flying Tiger Copenhagen kishte një përshtatje të natyrshme me tregun. Ne sjellim një gamë shumë të gjerë produktesh, të ndërtuar mbi dizajnin danez, funksionalitetin dhe kreativitetin, duke ruajtur çmime të aksesueshme për një bazë të gjerë konsumatorësh.

Zhvillimi i Flying Tiger Copenhagen mbështetet gjithashtu nga eksperiencia dhe kapacitetet e BALFIN Group, si një prej grupeve më të rëndësishme të investimeve në rajon. Për ne, kjo përbën një bazë të fortë për të ndërtuar një prani të qëndrueshme dhe afatgjatë në tregjet ku operojmë.

Ecurinë e deritanishme në Shqipëri e vlerësojmë pozitivisht. Mënyra se si është pritur marka dhe interesi i konsumatorëve kanë qenë inkurajuese dhe na kanë dhënë besim për të vijuar zhvillimin tonë. Zgjerimi edhe jashtë Tiranës është një tregues i kësaj qasjeje dhe i potencialit që shohim në tregun shqiptar në një perspektivë afatgjatë.

**2. Flying Tiger Copenhagen njihet për kombinimin e dizajnit danez, funksionalitetit dhe çmimeve të aksesueshme. Si është pritur ky koncept nga konsumatori shqiptar dhe në çfarë mënyre përshtatet ai me mënyrën e blerjes dhe stilin e jetesës në rajon?**

Një nga karakteristikat e Flying Tiger Copenhagen është se, pavarësisht identitetit të tij të qartë danez, koncepti është lehtësisht i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për tregje të ndryshme.

Në Shqipëri dhe në rajon, familja, shtëpia, dhuratat dhe momentet e kaluara së bashku kanë një rëndësi të veçantë. Një pjesë e konsiderueshme e gamës sonë lidhet pikërisht me këto momente: nga produktet për shtëpinë dhe fëmijët, te artikuljt krijues, festat, dhuratat apo aktivitetet që mund të zhvillohen së bashku me familjen dhe miqtë.

Konsumatori vendas ka reaguar mirë edhe ndaj mënyrës se si ne e trajtojmë dizajnin. Edhe një produkt relativisht i thjeshtë mund të ketë një element krijues, funksional apo të papritur. Kjo i jep më shumë vlerë përvojës së blerjes dhe është në përputhje me filozofinë tonë.

**3. Zgjerimi në tregje të reja nuk lidhet vetëm me hapjen e dyqaneve, por edhe me ndërtimin e një strukture të qëndrueshme operacionale dhe organizative. Si po zhvillohet prania e kompanisë dhe çfarë roli kanë investimet në ekipet dhe kapacitetet lokale në këtë strategji?**

Për ne, zgjerimi nuk matet vetëm me numrin e dyqaneve. Që një biznes të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, duhet të ndërtohen paralelisht strukturat, proceset dhe ekipet që mund ta mbështesin këtë rritje në afat të gjatë.

Flying Tiger Copenhagen aktualisht operon në katër tregje dhe plani ynë është që deri në fund të vitit 2027 të jemi të pranishëm në gjashtë tregje. Kjo rritje kërkon investime jo vetëm në rrjetin e dyqaneve, por edhe në organizatë, në ekipet lokale dhe në ndërtimin e kapaciteteve që mund të mbështesin zhvillimin e biznesit në secilin treg.

Kemi nevojë për ekupe që njohin tregun, kuptojnë konsumatorin dhe njëkohësisht janë në gjendje të zbatojnë standardet dhe kulturën e një marke ndërkombëtare si Flying Tiger Copenhagen.

Në të njëjtën kohë, operimi në disa tregje na mundëson të ndajmë përvojat, të ndërtojmë procese më efikase dhe të krijojmë një strukturë që mund të mbështesë jo vetëm rritjen aktuale, por edhe zgjerimin e mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme.

**4. Pas pothuajse një viti aktiviteti në Shqipëri, cilat janë mësimet kryesore që keni marrë nga tregu? A ka pasur elemente që ju kanë surprizuar në sjelljen e konsumatorit, performancën e kategorive të produkteve apo mënyrën se si është perceptuar marka?**

Një nga mësimet kryesore ka qenë se konsumatori shqiptar e ka kuptuar relativisht shpejt konceptin e Flying Tiger Copenhagen. Marka është pritur mirë nga profile shumë të ndryshme konsumatorësh, gjë që konfirmon se produktet tona nuk kufizohen në një kategori apo grupmoshë të caktuar.

Kemi parë interes si për produktet funksionale të përdorimit të përditshëm, ashtu edhe për kategoritë me një element më të fortë krijues, dekorativ apo argëtues. Gjithashtu, koleksionet sezonale dhe produktet që lidhen me momente specifike të vitit kanë treguar se konsumatori shqiptar reagon mirë ndaj risisë dhe ndryshimit të vazhdueshëm të produkteve tona.

Një tjetër element pozitiv është gatishmëria e konsumatorit për t'u rikthyer në dyqan. Për ne kjo është shumë e rëndësishme, sepse një pjesë themelore e konceptit është pikërisht zbulimi: dyqani duhet të ofrojë vazhdimisht arsye të reja për t'u vizituar.

**5. Sektori i shitjes me pakicë po transformohet me shpejtësi, i ndikuar nga digjitalizimi, ndryshimi i sjelljes së konsumatorit dhe rritja e vëmendjes ndaj qëndrueshmërisë. Si po i adreson Flying Tiger Copenhagen këto zhvillime dhe cilat konsideroni prioritetet kryesore strategjike për vitet e ardhshme?**

Sjellja e konsumatorit po ndryshon dhe, bashkë me të, po ndryshon edhe roli i dyqanit fizik. Ne besojmë se dyqani vazhdon të ketë një rol qendror, veçanërisht për një koncept si Flying Tiger Copenhagen, ku kontakti me produktin, prezantimi dhe elementi i zbulimit janë pjesë e rëndësishme e përvojës.

Nga ana tjetër, kanalet digjitale na mundësojnë ta zgjasim këtë marrëdhënie edhe përtej vizitës në dyqan. Ato janë një mjet i rëndësishëm për të prezantuar produktet dhe koleksionet e reja, për të krijuar frymëzim dhe për të komunikuar në mënyrë më të drejtpërdrejtë me konsumatorin.

Qëndrueshmëria është gjithashtu një drejtim që po merr gjithnjë e më shumë rëndësi për industrinë. Kjo lidhet me mënyrën se si mendohen produktet, materialet, paketimi dhe proceset e operimit.

Për tregjet ku operojmë sot dhe ato ku synojmë të zgjerohemi, prioritetet tona mbeten zhvillimi i kujdesshëm i rrjetit, konsolidimi i markës, përmirësimi i vazhdueshëm i përvojës së konsumatorit dhe ndërtimi i kapaciteteve që na mundësojnë të rritemi në mënyrë të qëndrueshme.

**6. Duke parë përpara, cili është vizioni juaj për zhvillimin e Flying Tiger Copenhagen gjatë viteve të ardhshme? Si e shihni zgjerimin e rrjetit në tregjet ku operoni sot dhe mundësitë për hyrje në tregje të reja europiane?**

Ambicia jonë është që Flying Tiger Copenhagen të ndërtojë një prani të fortë dhe afatgjatë në tregjet ku operojmë dhe, njëkohësisht, të vijojë zgjerimin edhe drejt tregjeve të reja europiane.

Aktualisht jemi të pranishëm në katër tregje dhe synimi është që deri në fund të vitit 2027 të operojmë në gjashtë tregje. Paralelisht, po shikojmë mundësinë e zgjerimit të aktivitetit edhe në tre tregje të Bashkimit Europian, çka e vendos zhvillimin e kompanisë në një perspektivë më të gjerë se vetëm rajoni ku kemi nisur aktivitetin.

Zgjerimi i rrjetit të dyqaneve do të mbetet një pjesë e rëndësishme e strategjisë sonë, por qasja jonë nuk është të rritemi vetëm përmes numrit të pikave të shitjes. Çdo hap i ri duhet të mbështetet nga një strukturë e shëndetshme operacionale, nga ekipet e duhura dhe nga një kuptim i mirë i tregut ku hyjmë.

Në vitet e ardhshme do të vazhdojmë të investojmë në rrjetin e dyqaneve, në zhvillimin e ekipeve, në forcimin e markës dhe në përmirësimin e përvojës së konsumatorit.

Objekti ynë afatgjatë është të ndërtojmë një platformë të qëndrueshme zhvillimi për Flying Tiger Copenhagen, me një prani gjithnjë e më të gjerë europiane, duke ruajtur njëkohësisht atë që e bën konceptin tonë të dallueshëm: dizajnin, kreativitetin, aksesueshmërinë dhe kënaqësinë e zbulimit të diçkaje të re.

**MË SHUMË NGA AKTUALITETI**

**Aksident fatal në Lezhë, humbet jetën 50-vjeçari**

**Vetëdorëzimi i Vlora Hysenit, gazetarja Hoxha: Ishte në Azerbajxhan p...**

**Informacione të klasifikuara me Serbinë? Ekspertja paralajmëron për s...**

**Agron Duka për Vlora Hysenin: Ka kosto politike dhe kombëtare, minus ...**

**Zjarr i madh në Lazarat, fakët rrezikojnë banesat**

**Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit**

**LAJMET E FUNDIT**

Dita e 7-të e protestës në  
Prishtinë kundër vendimit nga  
Haga për ish-krerët e UÇK-së

9 ORË E 5 MINUTA MË PARË

Trazira në showbiz-in turk,  
aktorja e njohur merret në  
pyetje për hetimin e drogës

9 ORË E 18 MINUTA MË PARË

Aksident fatal në Lezhë,  
humbet jetën 50-vjeçari

9 ORË E 20 MINUTA MË PARË

Vetëdorëzimi i Vlora Hysenit,  
gazetarja Hoxha: Ishte në  
Azerbajxhan për një takim, BKH  
i trokiti në derë, por...

9 ORË E 28 MINUTA MË PARË

Informacione të klasifikuara me  
Serbinë? Ekspertja  
paralajmëron për sigurinë e  
Shqipërisë

9 ORË E 31 MINUTA MË PARË

Agron Duka për Vlora Hysenin:  
Ka kosto politike dhe  
kombëtare, minus për qeverinë  
shqiptare

9 ORË E 40 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991  
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.